

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ H&J PARTNERS SH.P.K”

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ **H&J PARTNERS SH.P.K**”. themelohet në përputhje me ligjin 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03/05/2007 për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”. Kjo shoqëri krijohet dt. **21/07/2023 nga:**

Znj.Suzana Aga, e bija e Agim Aga, lindur në Durrës më 25/04/1993, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I kartës së identitetit me nr J35425089L

Neni 2

Emërtimi I shoqërisë është “ **H&J PARTNERS SH.P.K**”

Neni 3

Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti krijohet me mjete private të themeluesit të saj.

Neni 4

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ **H&J PARTNERS SH.P.K**”.

Në përputhje me krijimin e kësaj shoqërie dhe me legjislacionin shiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.


Neni 5

Shoqëria “ **H&J PARTNERS SH.P.K**”. është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit në organet përkatëse. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat në dokumentat e krijimit të saj, kontratën dhe në këtë statut.

Neni 6

Shoqëria do të kryej aktivitet me objekt:

- Shërbime Programimi
- Konsultant Sap Ui5



- Kompani teknologjike në ndërtimin e Webeve, aplikacioneve
- Prodhim për pjesë makinerie
- Trajnim për burimet njerëzore
- Trajnim për menaxhim biznesi

Neni 7

Selia e shoqërisë “ **H&J PARTNERS SH.P.K**” është

Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Pjetër Bogdani Ndertesa 10, H 5. Apt 28. Kati 7 Tiranë , Shqiperi.

Neni 8

Shoqëria ushtron veprimtarinë e vetë të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprimtarie shoqëria mund të çelë degë, filiale dhe zyra të saja të përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

Neni 9

Shoqëria kryen veprimtarinë e vetë për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.

Neni 10

Pjesmarrja në shoqëri nuk e pengon ortakun të ketë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera e për të drejta të tjera pronësie.

Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti I veprimtarisë së saj tek kapitali themeltar.

Neni 11

Të drejtat kryesore të ortakut janë:

1. Pjesëmarrja në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kontratën dhe statutin e vet ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.
2. Pjesëmarrja në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në cdo formë dhe sasi qoftë në përputhje me statutin dhe kontratën.
3. Pjesëmarrja në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vet.
4. Te kërkojë t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentet e përpunuara të shoqërisë si bilanci, llogaritë ekonomike etj.
5. Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
6. Të emërojë dhe shkarkojë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Neni 12

Detyrimet e ortakëve janë:

1. Pjesëmarrja në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tij, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijon ai.
2. T'i japë shoqërisë informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
3. Të kryej shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

KREU II

Kapital I Rregjistruar

Neni 13

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabël dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

Neni 14

Kapitali themeltar I kësaj shoqërie është 100,000 (njëqindmijë) lekë, I ndare ne 1- nje kuote

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e mëposhtëmë:

- Ortaku themelues Suzana Aga: Zotërues i 1-një kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

Ortaku ka pavarësi ligjore organizative si dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm për kapitalin e saj.


Neni 15

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj, ortaku I shoqërisë ka të drejtën e rritjes në mënyrë proporcionale.

Neni 16

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie nëpërmjet bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve. Transferimi duhet të vërtetohet me akt notarial.

Neni 17



Shoqëria në emër të vetë është pronare, përdoruese e pasurive të saj gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen, Shoqëria mund të shesë pasurinë të shfrytëzohet të drejtat e tjera të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci dhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

Neni 18

Shoqëria krijon fonde rezervë ose fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj. Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondet rezervë, fondet e tjera ose nga shumat themeltare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakut të vetëm, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU III

Viti Financiar, Llogaritë vjetore, Ndarja e fitimit

Neni 19

Cdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Përrjashtimisht viti I parë financiar ka filluar në ditën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon më 31 Dhjetor të atij viti.

Neni 20

Pasqyrat Financiare vjetore të shoqërisë deklarohen brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Neni 21

Ortaku e dallon vetë humbjen e veprimtarisë së shoqërisë në të ardhmen.

Neni 22

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacinet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administrator dhe eventualisht nga eksperti kontabël I autorizuar miratohen nga ortakët e shoqërisë. Miratimi I dokumentave mbu veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.


Neni 23

Fitimi neto I realizuar nga shoqëria, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve si dhe fondet e lëna rezervë për nxitje ekonomike, për investime, për reklamën tregtare etj e përfiton ortakut I vetem i kompanis me 100% të vlerës.

KREU IV

Administrimi

Neni 24



Asambleja e përgjithshme thirret nga administrator të paktën 2 herë në vit, për të miratuar përkatësisht bilancin vjetor të mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.

Mbledhja e asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar me postë të zakonshme apo mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Ortakët që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të rregjistruar kanë të drejtë të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet administratorit ose pa ndërmjetësimin e tij.

Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e votave të ortakëve pjesëmarrës, (e cilësuar në këtë statut si (“ shumicë e thjeshtë”)

Mbledhja e Asamblesë për të vendosur për çështje të vecanta si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të rregjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se tret e katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës,(e cilësuar në këtë statut si “shumicë e thjeshtë”)

Neni 25


Administrimi i shoqërisë bëhet nga Administratori.

1. Asambleja e përgjithshme përcakton administratorin për një periudhë 5 (pesë) vjecare sipas parashikimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 81 dhe të nenit 95 të ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”. Emërimi do të jetë individual dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të ligjit.
3. Suzana Aga caktohet si Administrator i shoqërisë për një periudhë 5-vjecare.

Neni 26

Kompetencat e administratorit janë:

1. Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblesë, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar.
3. Miratimi i akteve normative që përcaktojnë raportet e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
4. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.



5. Krijimi I organeve të tjera të domosdoshme për realizimn e objektivave të shoqërisë.
6. Propozimi në mbledhjet e asamblesë për krijimin e njësive, strukturave, filialeve, degëve dhe përfaqësive në qytetet e tjera të vendit ose jashtë shtetit.
7. Përzgjedhja e Ekspertit Kontabël dhe antarëve të komisionit të likuidimit dhe paraqitja e propozimeve për miratim në asamble.

KREU V

Prishja dhe Njoftimet

Neni 27

Kontrolli I shpërisë mund të kryhet nga një Ekspert Kontabël I Autorizuar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga ortakët e shoqërisë. Shkarkimi I Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, ose kur bëhet e pamundur kryerja e detyrave.

Neni 28

Në rast likuidimi të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë cdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

KREU VI

Dispozita të fundit

Neni 29

Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të mbahen në një libër të vecantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

ORTAK I SHOQËRISË

Suzana AGA

